

raturë, për arsyen e vetme se ajo u është dedikuar rinisë me një qëllim të caktuar: të kultivojë shijen estetike duke e ushqyer atë me vlera të

njimendta nga thesari popullor. Dhe këtë qëllim ky libër e realizon me dinjitet.

NUHI VINCA

KËNGË TË NDRYSHME POPULLORE, Instituti Albanologjik i Prishtinës, përgatitur nga Nuhi Vinca, Prishtinë 1982, f. 420.

Kohëve të fundit kujdes i merituar po i kushtohet mbledhjes dhe botimit të materialeve të letërsisë popullore. Tashmë, në këtë fushë nuk mungon as numri i konsiderushëm i mbledhësve, dhe studiuesve të ndryshëm që merren me çështje të rëndësishme shkencore folklorike.

Instituti Albanologjik i Prishtinës, pas disa botimeve të suksesshme të materialeve të ndryshme nga letërsia popullore, këto ditë brenda projektit afatgjatë prej njëzet e pesë blenjve të thesarit popullor shqiptar, nxori edhe vëllimin e nëntë *Këngë të ndryshme popullore*, përgatitur nga Nuhi Vinca.

Librit i prin një parathënie e gjatë, në të cilën bëhen njoftime mbi këngët e përfshira në këtë ble, duke theksuar se gjatë mbarështrimit dhe klasifikimit të lëndës si kriter bazë ka pasur parimin tematiko-motivor, duke mos lënë anash as atë estetik. Ai, gjithashtu ka respektuar parimin territorial dhe është përpjekur të sjellë lëndë folklorike nga të gjitha viset ku kultivohet folklori shqiptar në Jugosllavi.

Në këtë pjesë të librit Nuhi Vinca njofton poashtu edhe për vështirësitë jo të pakta që iu kanë paraqitur gjatë klasifikimit të materialit folklorik, duke theksuar se është përpjekur që në këtë libër të gjejnë vend krijimet më të mira të botuara a të pabotuara.

Përpiluesi librin e ndan në pesë pjesë, kryesisht sipas tematikës dhe motiveve, ku për secilin grup shkurtazi flet në parathënie, duke i gërshetuar mendimet dhe njohuritë e veta me të arriturat shkencore bashkëkohore në fushën e folkloristikës. Një analizë sintetike dhe analitike, Nuhi Vinca ua bën sidomos këngëve të kurbetit, ku, nëpërmjet shembujve konkretë marrë nga libri, arrin të depërtojë thellë në botën shpirtërore të kurbetçinjve dhe anëtarëve

të familjeve të tyre, të cilët zhuriten nga malli për njëri-tjetrin në hapësirë dhe kohë të ndryshme.

Pjesa e parë, *Këngë pune* përfshin në vete pesë grupe të cilat poashtu janë sistemuar sipas motivit dhe tematikës: a) *Këngë punë për bujqësinë*; ose thënë më mirë *Këngë që këndojnë bujqësinë*; b) *Këngë pune mbi zeje të ndryshme në familjen patriarkale*; c) *Këngë punësh të ndryshme shtëpiake* ç) *Këngë pune mbi bletarinë*, ose *Këngë për bletët*; d) *Këngë baritore*.

Vlen të theksohet se në këtë ble janë përfshirë rreth 300 këngë të mirëfillta pune, që, sipas Nuhi Vincës, duke i krahasuar me botimet e deritashme, është shembulli i parë dhe i vetmi në botimet folklorike në përgjithësi. Këngët kryesisht shquhen përnga theksi i punës dhe aty-këtu mund të hetohen edhe gërshetime të ndonjë motivi tjetër. Tendenca e përpiluesit ishte që të përfshijë sa më shumë këngë që këndohen drejtpërdrejt gjatë procesit të punës. Thuhet se kënga ka lindur së bashku me njeriun dhe si e tillë e ka ndjekur me shekuj rritjen dhe procesin e punës së tij. Mjafton t'i vështrojmë disa këngë të punës për të vështuar mendimin e tillë. Fati i jetës së njeriut është i lidhur ngushtë me natyrën, andaj identifikimi i tij me tokën, diellin, ujin, kafshën, bimën e tj., e sidomos me rritjen e bimës në këngë, na del fare i natyrshëm.

Kulti ndaj punës është preokupim kryesor që trajtohet në këto këngë. Këngëtari popullor me admirim të madh i këndon punës, duke e konsideruar atë si të shenjtë, të mirë, të drejtë, të ndershme, fisnike e mbi të gjitha të dobishme.

Kurse në ciklin *Këngë për zeje të ndryshme* janë përfshirë ato këngë që kanë për objekt trajtimin e zejeve të ndryshme që i aplikon njeriu gjatë jetës dhe procesit të punës, si ndërtimi i çerepëve prej lloçi, tje-

rrja, punët e vekut, të mognës, qepjet dhe qëndisjet e ndryshme etj.

Këngë për punët shtëpiake është nënloji i këngëve të punës, ku bëhet fjalë për punët e ndryshme që kryhen në shtëpi si ndezja e zjarrit, sitja e miellit, mjelja e shtazëve, tunja e bulmetit, fshirjet, si dhe punët e tjera të magjetores etj.

Në *Këngë për bletët*, autori ka sjellë një mori këngësh dhe variantesh të ndryshme, marrë nga territoret e ndryshme të vendit tonë, që janë me interes për studiuesit, ku vërehet qartë ndjenja e thellë e dashurisë dhe e respektit të njeriut ndaj bletës në përgjithësi.

Në *këngët baritore (blegtorale)*, fli-tet për marrëdhëniet e njeriut me kafshët shtëpiake si qenie të gjalla me të cilat e ka lidhur fatin e jetës. Këtu vend të posaçëm zënë sidomos *Këngët e „Kulaçit“*, ku buka-kulaçi, të cilin nënat e gatujnë nergut për ketë festë të barinjve, simbolizon rritjen e mbarë dhe të shëndoshë të bagëtisë në përgjithësi.

Ndarja e këtyllë e këngëve të punës në disa grupe na duket jo vetëm origjinale, por edhe e drejtë, sepse një ndarje e këtyllë ta imponon vetë lënda folklorike, pra vetë këngët të cilat flasin me veçoritë e tyre.

Pjesa me peshë të veçantë artistike e semantike janë *Këngët e kurbetit*, që trajtojnë kurbetin si fenomen individual e shoqëror. Ky lloj i lirikës popullore ngërthen në vete këngët më të fuqishme, më tronditëse, më mallëngjyese, më të dhembshme dhe artistikisht e semantikisht më të pasura si në pikëpamje të dimensionit ideor ashtu edhe atij emocional. Kurbeti në të kaluarën ishte plagë e rëndë shoqërore me përmasa të gjera kombëtare, e cila shumë herë shkaktoi tragjedi të ndryshme. Këtë barrë populli e ndien thellë në kurrizin e tij, kurse poetët popullorë u frymëzuan dhe i krijuan veprat më të dhembshme kushtuar njeriut të „vogël“, i cili çan rrugët e mërgimit nëpër meridiane të ndryshme të botës.

Vërtet dhembja ndaj kurbetit është e rëndë, e madhe, e thellë, rrëqethëse, tronditëse, mallëngjyese — „Asgjë nuk na bën të mëdhenj sa dhembja e madhe“ thoshte dikur poeti i njohur frances Alfred de Muse

prandaj lindin këngë të ndryshme, të cilat me botën e tyre shprehin dramën më beshnike të realitetit në periudha të caktuara historike.

Kush është i kënaqur është edhe i pasur, thoshte filozofi i njohur kinez qysh në shek. VI, Konfuçie. Vërtet të kesh nuk do të thotë të jesh edhe i kënaqur, andaj dashuria, malli ndaj familjes, vendlindjes, të dashurës, të dashurit, farefisit e të tjerëve është shumë më i madh se pesha e rëndë e florinjve, prandaj në këngën popullorë veleshtare thuhet: — Ah, ç'më duen të shkretët flori-e-o / U treta për toj un' si çiri-e-o (F. 158). Do theksuar se në këto këngë të shumta, e bukura, shpesh duket edhe e shëmtuar, varësisht nga ndjenja, përjetimi dhe koha që determinon disponimin e kurbetçiu. Në këto raste shqetësimi ose galdimi duket se është aq i madh sa i mërguari shpirtërisht identifikohet me natyrën, stinën, erën, detin, muajin, ditën, orën, minutën etj., duke i shikuar dhe përjetuar thellësisht nëpërmjet vizionit të tij subjektiv e meditativ. Njëlloj tabloje të këtyllë më duket se shpreh kënga metaforike *Fluturojshin dy flutra të verdha*, që në mënyrë apostrofike, simbolike dhe metaforike stina e lulëve provokon ndjenjën, mendimin dhe dashurinë e nuses së re, të vëtmuar, që ndien zbrazëti jetësore e shpirtërore. Dy flutura të verdha në këngë simbolizojnë dy zemra të dashuruara, të pafat, të mallëngjyera, të cilat korrespondojnë në mes veti me fije të padukshme në hapësirë dhe interval kohe të ndryshëm. Pra, ngjyra e verdhë simbolizon mallin, trishtimin, pikëllimin etj., që ornamentohet në këngë: Fluturojshin dy flutra të verdha / Ori ti nonë, si duket vera? / — Po ver'e simjeçme, shumë e hershme / Pa Sabri dilberin e përbetshme; / Po verë e sivjeçme e gjelbrueshme / Pa Sabri dilberin e shëmtueshme / (F. 169).

Personazhi i nënës në këtë këngë është i dorës së dytë, përkatësisht është në shërbim të idesë kryesore të këngës, zëdhënës informatik në valë dhe kohë të njëjtë të mallëngjimit, të dashurisë, që gufon nga zemrat e dy të rinjve.

Rrëqethëse dhe tronditëse janë skenat e sëmundjes për vdekje të kurbetçinjve të rinj që paraqiten në

këngët popullore, e sidomos para vdekjes, kur ua lënë amanet shpendëve që t'ua transmetojnë porosinë e fundit nënës dhe farefisit.

Në këtë vepër radhiten shumë këngë të këtilla e me vlerë antologjike. Mirëpo ajo që bie në sy në këtë pjesë të librit me këngë të kurbetit është sidomos fakti që këngët paraqesin kurbetin në diakroni dhe sinkroni, duke na dhënë, pra, tabllo të gjalla e trishtuese si për kurbetet e së kaluarës ashtu edhe të kurbetit të tanishëm që, siç theksohet edhe në parathënie, këndohet në rrethana të reja e më të favorshme sesa kontekstet kohore të së kaluarës.

Vend të rëndësishëm në këtë libër zënë *Këngët humoristike*, të cilat vënë në thumb të kritikës disa të meta dhe dukuri të ndryshme negative individuale e kolektive, që nuk përkojnë me normat e moralit njerëzor. Këngët i përshkon një frymë e lehtë humori e satire, e cila, në rastet më të shpeshta, nuk kanë qëllim fryes, por tentojnë të nxisin të qeshurën dhe njëherazi të stigmatizojnë disa dukuri jo të mira si përtacinë, ryshfetin, rrenën e t.j. Ka edhe këngë të atilla që paraqesin vetëm lojë fjalësh të ndryshme, por të thurura me mjeshtëri, të cilat lexuesit dhe dëgjuesit i tingëllojnë mjaft simpatike.

Si pjesë e veçantë janë paraqitur *Këngët e kapuçave*, që njihen si krijime popullore mjaft të vjetra dhe të përhapura edhe sot kryesisht në disa vise. Këto këngë dëshmojnë për argëtimin e njeriut të këtyre trojeve që nga kohët më të hershme e deri më sot, dhe për nga struktura kompozicionale janë mjaft të thjeshta, por për nga mesazhi artistik e semantik, si dhe për nga mjetet shprehëse figurative, tejet të ngjeshura dhe interesante.

Lidhur me këto këngë me të drejtë, në parathënie theksohet se janë të panjohura për popujt e tjerë të Ballkanit, bile janë të panjohura edhe për disa treva folklorike shqiptare. Si të tilla këto këngë kanë rëndësi të posacme për folkloristikën në përgjithësi.

Në pjesën e fundit të këtij vëllimi gjejnë vend *Këngët e ndryshme*, të cilat për nga tematika dhe motivet nuk mund të klasifikohen në as-

njërin grup tjetër, përveç si grup në vete. Këto këngë si të tilla kanë karakter gnosologjik, zbavitës, didaktik, por edhe shquhen për vlera të tjera artistike, semantike e estetike etj. Numri i tyre është mjaft i madh, prandaj botimi i tyre në këtë përmbledhje është i arsyeshëm dhe me interes për studiuesit e folkloristikës sonë.

Bleni *Këngë të ndryshme popullore* përfshin në vete 602 njësi (këngë), ku pjesa më e madhe e tyre e shohin dritën për herë të parë. Në fund të librit jepet fjalorthi i fjalëve të rralla, pastaj shënimet për këngëtarët (265 sish) dhe mbledhësit (70 sish) të njërive folklorike.

Në këtë përmbledhje, sikurse edhe në çdo vepër tjetër të këtij lloji, mund të hetohen edhe disa të meta të vogla, të cilat iu kanë përvjedhur përpiluesit gjatë mbarështrimit dhe klasifikimit të lëndës. Ndonjë këngë, që është futur në një cikël, i takon ciklit tjetër. Një gjë e tillë ka ndodhur, siç thotë vetë përpiluesi, për shkak të natyrës së krijimeve popullore në tërësi. Çështja e klasifikimit të krijimeve popullore, siç dihet në shkencën e folkloristikës, paraqet problem të veçantë, të hapur dhe me peshë të caktuar për hulumtim e studim teorik e praktik, prandaj edhe vështirësitë e kësaj pune janë të shumta.

Do theksuar se gjatë mbarështrimit të materialeve, përpiluesi kujdes të veçantë i kushtoi edhe shtrirjes regjionale si dhe ruajtjes të së folme origjinale të atij vendi ku janë shënuar këngët. Rëndësi të posacme në libër ai i kushtoi edhe zgjedhjes së titujve të këngëve, që deri diku shprehin poentën dhe tërësinë kuptimore të këngës. Gjatë leximit të këtij bleni bien në sy edhe disa të meta të vogla, më tepër të karakterit teknik, siç është përsëritja e një këngë (F. 85) apo mospërputhja e ndonjë numri të këngës me mbledhësin etj.

Në fund po theksojmë se vepra *Këngë të ndryshme popullore* sjell lëndë të pasur folklorike nga trevat e banuara me shqiptarë. Në parathënie të veprës së tij Nuhi Vinca ka shtruar çështje të rëndësishme folklorike, duke u bërë një qasje argu-

mentuese e bindëse, sidomos sa i përket aspekteve të brendshme të këngëve të punës, të këngëve të kurbetit, atyre të humorit, të kapuçave si dhe ndaj grupit të veçantë të këngëve që këtu me të drejtë janë pagëzuar *Këngë të ndryshme popullore*. Gjithashtu edhe ndarja, klasifikimi në pesë lloje këngësh të përfshira në

këtë ble, marrë në tërësi është respektuar.

Vëllimi *Këngë të ndryshme popullore* përmban kryesisht lëndë deri tash të pabotuar, prandaj është me interes dhe paraqet kontribut të rëndësishëm për folkloristikën tonë.

ADEM ZEJNULLAHU

Dr. Fazli Syla, POEZIA POPULLORE SHQIPTARE E KAÇAKËVE, Instituti Albanologjik i Prishtinës, Prishtinë 1982.

Studimi monografik i dr Fazli Sylës „*Poezia popullore shqiptare e kaçakëve*” është vepra e parë e folkloristikës shqiptare që trajton çështjen e një zhanri të poezisë popullore, si edhe studimi i parë nga fusha e folklorit, që po e boton Instituti Albanologjik. Kjo vepër trajton një problematikë interesante, sepse në mënyrë të shumanshme e ndriçon reflektimin e lëvizjes së kaçakëve në poezinë tonë historike, duke e përcjellë dukurinë e kaçakërisë që nga zanafilla e deri në prag të Luftës së Dytë Botërore. Interesimi i autorit të këtij studimi ka pikënisje të dyanshme: e para, që nëpërmjet këngës popullore t'i zbërthejë komponentet sociale, politike, historike, kombëtare dhe moralo-etike të dukurisë së kaçakërisë në planin e gjerë historik të tri periudhave të rëndësishme të historisë së popullit shqiptar dhe, e dyta, ta studiojë strukturën poetike të këngëve të kaçakëve. Vlen të theksohet që në fillim se autori e ka vështruar lëndën e studimit të vet edhe nga një aspekt shumë i rëndësishëm, në relacionin krahasimtar me këngët e popujve të tjerë të Ballkanit, të cilat u kushtohen lëvizjeve të ngjashme të popujve të tyre në periudha të caktuara të marrëdhënieve shoqërore të kushtëzuara nga rrethanat historike të kohës.

Libri i dr Fazli Sylës bashkë me hyrjen ka gjashtë kaptina dhe gjithsej 190 faqe. Në hyrje autori, përveç përkufizimeve të caktuara lidhur me lëvizjen e kaçakëve si formë e rezistencës kundër shfrytëzimit social dhe shtypjes kombëtare, flet edhe për shtrirjen territoriale dhe kohore të këngëve të kaçakëve duke përcaktuar edhe periudhat historike të

lëvizjes dhe lidhjet e saj me lëvizjen e përgjithshme kombëtare dhe luftën e popullit tonë për liri gjatë shekullit XIX dhe në katër dhjetëvjetëshat e parë të shekullit XX. Në këtë pjesë të studimit autori, duke u nisur nga qëllimi i studimit të tij, jep edhe disa sqarime lidhur me përparësitë e metodologjisë, e cila zbatohet për studimin e kësaj problematike të rëndësishme për kulturën shpirtërore të popullit tonë.

Kaptina e dytë e librit i kushtohet gjenezës së këngëve popullore të kaçakëve. Në fillim paraqiten kushtet ekonomiko-shoqërore të periudhës së sundimit osman, kur lëvizja e kaçakëve, si formë e vazhdimësisë së rezistencës kundër sundimit të huaj, kishte pikënisje nga rebelimi individual kundër shfrytëzimit të pamëshirshëm të shtresave të gjera të fshatarësisë shqiptare. Në bazë të kronologjisë autori e trajton edhe periudhën e mëvonshme dhe aspektet historike e sociale të lëvizjes së kaçakëve në vitet 1912—1941, duke u ndalur në mënyrë të veçantë në reflektimin e kushteve të vështira të shtypjes kombëtare të popullësisë shqiptare të Kosovës dhe të viseve të tjera nën sundimin e Jugosllavisë së Vjetër për vazhdimësinë e kaçakërisë deri në vitin 1941. Duke u bazuar në aspektet historike dhe sociale të lëvizjes dhe të transponimit të saj artistik në këngët popullore, autori e zbërthen shkallëzimin e rezistencës kundër sundimit të huaj duke filluar nga rebelimi i individëve kundër shfrytëzimit feudal, organizimi i grupeve të kaçakëve dhe veprimi i tyre në radhët e kryengritjeve të përgjithshme popullore e deri te pjesëmarrja e drejtpërdrejtë e kaçakëve në